

VENDIM
Nr. 116, datë 24.5.2022

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SPV BLUE 1” SHPK NË VEPRIMTARINË
E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK
“BLUE 1” ME VENDNDODHJE NË ZONËN E SHEQ MARINAS, BASHKIA FIER,
ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 mw**

(Ndryshuar me vendimin nr. 206, datë 10.8.2022)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.5.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 771/7 prot., datë 20.5.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘SPV Blue 1’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik ‘Blue 1’, me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 mw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 2, datë 13.1.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik “Blue 1” me kapacitet të instaluar 50 mw, për një afat 30-vjeçar, me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier.

- ERE, me shkresën nr. 70/1 prot., datë 14.1.2022, njoftoi në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve nga të tretët (data 24.2.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla.

- Në vijim, shoqëria është njoftuar për vendimin dhe i është kërkuar plotësimi i dokumentacionit. Po ashtu në analizë të këtij aplikimi janë zhvilluar disa seanca dëgjimore. Shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. ka dërguar dokumentacion në kuadër të plotësimeve të kërkuara.

- Nga shqyrtimi që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k., rezulton se janë plotësuar kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si më poshtë:

- formatin dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”;
- dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”;
- dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “d”;
- dokumentacionin teknik për centralin fotovoltaik, neni 9, pikat 4.4.1; 4.4.2, 4.4.3, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, pika 4.4.4 germat: “a”, “b”, “c”, “d”;
- leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.4.5, germat “a” dhe “b”.

- I vetmi dokument që mbetet pa plotësuar është dokumenti që vërteton pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (certifikata pronësie, kontrata shitblerje, kontrata qiramarrje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjekte private ose shtetërore që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete të paluajtshme, etj.). Shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE certifikatat e regjistrimit të pronësisë për pasuritë me nr. 535/3, nr. 622 dhe nr. 537, përpara vënies në operim të veprës.

- Kontratat nr. 2720 rep. dhe nr. 2066 kol., të datës 9.7.2021, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike ‘Blue 1’ me kapacitet të instaluar 50 mw dhe veprave ndihmëse, i cili nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën Sheq Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria ‘SPV Blue 1’ sh.p.k.”, të nënshkruara

ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), në cilësinë e autoritetit kontraktues dhe shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k. në cilësinë e mbajtësit të miratimit përfundimtar, ka një afat 49-vjeçar, por ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

- Në rastin konkret, duke qenë se nga studimi i fizibilitetit të centralit fotovoltaiik “Blue 1” rezulton se jetëgjatësia e moduleve fotovoltaike shkon 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “SPV Blue 1” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Blue 1”, me kapacitet të instaluar 50 mw, për një afat 25-vjeçar duke filluar nga data e operimit, por jo më vonë se data 1.7.2023.

2. *Shfuqizuar.*

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

4. *Shfuqizuar.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti